



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe
Mbledhja nr. 36/18
Prishtinë, më 21.11.2018, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL

Në mbledhjen morën pjesë: Lumir Abdixhiku, Safete Hadergjonaj, Jelena Bontic, Naser Osmani, Mërgim Lushtaku, Ali Lajçi, Arbërie Nagavci, Enver Hoti. Blerim Kuçi dhe Fikrim Damka.

Mungoi: Dardan Molliqaj.

Pjesëmarrës i ftuar: Bedri Hamza- Ministri i Financave, Lulzim Rafuna -Këshilltar i Ministrisë, Salvador Elmazi-Drejtori i departamentit të buxhetit në NMF, Milaim Aliu - Udhëheqës i divizionit të buxhetit qendror,

Pjesëmarrësit tjerë: Albulena Haxhiu-Deputete nga GPLVV, Shemsi Sylaj-Deputet nga GPLVV, Feride Zeka-nga Ambasada Britanike, Shqipron Xhema-nga KDI, Vatra Çehaja nga GPLVV, Besjana Bajrami-nga Ekonomia Online, Majlinda Doda-nga RTK, Muhamet Spahiu- Këshilltar nga AAK, Blendon Arifi-Praktikant nga UP, Xheneta Murtezaj- nga Kallxo.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini, Luljetë Krasniqi dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Lumir Abdixhiku – Kryetar (tutje kryetari).

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 14.11.2018;**
- 3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L-133 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe i amendamenteve të Komisionit funksional për Punët të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së;**
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-115 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2003/24, Ligji i Sportit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin 04/L-075 për ndryshimin dhe plotësimin**

- e Ligjit nr.2003/24 për Sport dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi;
6. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.05/L-090 për sponsorizime në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi;
 7. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.05/L-075 për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive, dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi;
 8. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari: Konstatoi se rendi i ditës miratohet unanimisht pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 14.11.2018

Kryetari: Konstatoi se Komisioni unanimisht miratoi procesverbalin nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 14.11.2018, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi në parim i projektligjit nr.06/L-133 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019

Kryetari: Ja kaloj fjalën Ministrin për të paraqitur dhe arsyetuar projektbuxhetin për vitin 2019.

Bedri Hamza: Gjatë përgatitjes së këtij draft buxheti, prioritet për financim janë bazuar në dokumentet tona kryesore strategjike, siç janë: programi i Qeverisë që mbështetet tek strategjia për zhvillim ekonomik, programi për reforma ekonomike, strategjisë sektoriale dhe natyrisht korniza afat mesme e shpenzimeve që reflekton këto prioritete të politikave ekonomike. Projektbuxheti përmban edhe Kornizën Makro-fiskale.

Në bazë të projeksioneve të Ministrisë së Financave në vitin 2019, rritja ekonomike e vendit pritet të jetë 4.7% në terma real, ndërsa në atë nominal rritja ekonomike do të jetë 5.4%. Kjo rritje e projektuar pritet të mbështetet mbi të gjitha nga niveli i rritur i investimeve private, investimeve publike, konsumit dhe rritja e eksporteve të vendit. Për sa i përket çmimeve për vitin 2019 dhe vitet vijuese pritet një stabilitet i theksuar ku inflacioni është i projektuar të jetë më pak, mbi 1% në baza vjetore.

Të hyrat totale buxhetore do të jenë në vlerë prej 1 miliard e 949 milion euro dhe po flasim për të hyrat të cilat vinë nga tatimet dhe taksat, gjë që paraqet një rritje prej 7.3% në raport me vitin paraprak 2018, ose në vlerë nominale prej 132 miliardë euro. Kjo rritje e projektuar pritet të vijë kryesisht nga të hyrat tatimore me një rritje prej 7.7%, ndërsa brenda të hyrave tatimore, tatimet direkte pritet të rriten 5%, ndërsa ato indirekte me mbi 8%. Rritja e bazës tatimore si konsumi, investimet dhe importi prodhojnë nga 5 deri në 6% të të hyrave shtesë, ndërsa pjesa tjetër nga 1-2% do të arkëtohen duke përmirësuar administrimin e tatimeve dhe duke zbuluar stokun e borxhit tatimor.

Për sa i përket projeksionit për uljen e stokut të borxhit tatimor, po ashtu në bashkëpunim me Fondin Monetar Ndërkombëtar, ne kemi përfshirë në draft ligjin e buxhetit në një nen që lidh ekzekutimin e shpenzimeve me mbledhjen e të hyrave, pra në rast të mos mbledhjes së të hyrave ndikimi në shpenzime dhe deficit do të jetë neutral. Kjo është një qasje që mund të konsiderohet ambicioze për arritjen e formalitetit por duke qenë të sigurt për mbarëvajtjen e stabilitetit fiskal.

Për sa i përket të hyrave jo tatimore ato pritet për afërsisht të mbesin në nivele të njëjta përgjatë periudhës afatmesme, si ato të nivelit po ashtu edhe ato të nivelit lokal. Mbi të hyrat buxhetore ne kemi planifikuar pranimin prej financimit në draft me vlerë prej 421 milion euro neto, duke përfshirë 121 milion projekte te reja në bazë të klauzolës së investimeve ,54 milion projekt kredi të rregullta,140 milion fonde nga likuidimi që vinë nga Agjencioni Kosovar i Privatizimit, 135 milion nga instrumentet direkte të borxhit, kjo përmby obligimet për shlyerjen e borxhit ekzistues që është 50 milion euro në vitin 2019.

Do të ketë rritje të theksuar për financimin e projekt kapitaleve me karakter publik gjë që do të ndikojë direkt në rritjen e produktivitetit në sektorin privat. Rritje do të ketë në të gjitha kategoritë ekonomike duke mbajtur një buxhet të balancuar midis shpenzimeve rrjedhëse dhe atyre kapitale. Rritje do të ketë edhe për nivelin lokal, financimi direkt përmes komunave dhe indirekt përmes ministrive dhe kjo rritje do të vijë vetëm nga të hyrat e granteve të nivelit qendror.

Gjithsej, shpenzimet buxhetore do të jenë 2 miliard e 365 milion euro që paraqet një rritje prej 261 milionë euro,apo shprehur në përqindje 12.5% më shumë se në vitin 2018. Kemi rritje të planifikuar prej 13% në shpenzimet rrjedhëse, ku mallrat dhe shërbimet rriten për 27% ose 72 milion euro, duke reflektuar rritjen substanciale për mallrat për komunat e Kosovës, rreth 10 milion rritje për barnat esenciale dhe mbi 20 milion euro që i kemi adresuar vërejtje të auditorit për problemet e akumuluar me vite siç ka qenë keq klasifikimi, kemi pasur rast edhe blerjen e librave që ka qenë e kategorizuar si investim kapital.

Subvencionet dhe transferet për 16% apo 83 milion euro humbje, 30 milion janë të dedikuara për rritjen e pensioneve bazike dhe kontributeve për ofrimin e financimit të plotë për skemat e reja të filluara vitin e kaluar siç janë personat paraplegjik dhe tetraplegjik, viktimat e dhunës seksuale dhe personat e paaftë për vendin e punës, për rritjen dhe mbarëvajtjen e subvencioneve ne bujqësi si dhe për rritjen e subvencioneve të tjera.

Investimet kapitale nga ana tjetër kanë edhe rritje për 11% apo 75 milion euro kur në total janë 770 milion euro niveli i investimeve kapitale. Për sa i përket investimeve kapitale kjo rritje e shpenzimeve vjen si rezultat i përmbyshjeve të nevojave të mëdha të ekonomisë vendore për investimet e projekteve me karakter publik duke mundësuar financimin e shumë projekteve ekzistuese dhe të reja. Pjesa e rëndësishme e investimeve kapitale mbetet në projektet si: fillimi i autostradës Kijevë-Zahaq, financimi shtesë për autostradën Prishtinë-Gjilan, vazhdimi i projektit M2 për Mitrovicë, fillimi i rehabilitimit të tërësishëm të linjës hekurudhore Hani i Elezit-Fushë Kosovë, stadiumi kombëtar, ndërtimi i shkollave dhe laboratorëve të rinj, rehabilitimin dhe zgjerimin e infrastrukturës spitalore, dhe investimet e tjera për përmirësimin e infrastrukturës regjionale dhe lokale, infrastrukturës sportive dhe arsimore, rrjetit të ujit dhe kanalizimit.

Kemi ofruar rritje për financim lokal ku granti i përgjithshëm është rritur për 7.1 milionë euro ka mbërritur në 181 milion euro, për shëndetësi 4.9 milion euro që si grant ka mbërrir mbi 53 milion për arsim 14.7 milion rritje. Deficiti buxhetor dhe borxhi publik për vitin 2019 pritet të jetë 2% e bruto produktit vendor që është në linjë me kufirin e lejuar sipas ligjit të financave publike. Mbi këtë deficit do të ketë financim shtesë përmes klauzolës së investimeve në shumë prej 121 milion euro dhe fondet nga AKP-ja në vlerë prej 140 milion euro,

Kryetari: Unë kam analizuar projektbuxhetin në aspektin makroekonomik dhe politik. Sa i përket aspektit makroekonomik unë do të nisem prej treguesit kryesorë të analizës makroekonomike, pra prej rritjes ekonomike e cila është paraparë për tri vitet e ardhshme të jetë rreth 4.5%. Përderisa qeveria të cilën ju e përfaqësoni premtori rritje ekonomike prej 10% dhe vjen me një plan qeverisës që ofron 6 deri në 8% rritje ekonomike dhe në fund na përfundon me një buxhet që në mesatare për tri vitet e ardhshme 4.5%. Kjo na e dëshmon që plani qeverisës në radhë të parë ka qenë joreal pra ai plan që e kemi diskutuar në parlament dhe ky buxhet kanë mospërputhje të dyfishtë. Për mendimin tim për numrat që prezantohen në projektbuxhet është e pamjaftueshme për të akomoduar vendet e punës, numri më shqetësues në buxhet ishte ai i të punësuarve që i referohet Agjencisë së Statistikave të Kosovës, por

nëpërmjet dokumentit më të lartë financiar na konfirmohet se në vitin 2018 në dy kuartalet e para janë humbur 16 mijë vende të punës në Kosovë.

Shqetësime të mëdha kam edhe për deficitin tregtar në pjesën makroekonomike dhe me faktin që ne si Kosovë ta kthejmë këtë disbalancë eksport-import që e kemi tash 20 vite dhe kur 86% të hyrave siç e thotë buxheti shkojnë në konsum, i bie që çdo para që e krijojnë në Kosovë kanalizohet në import. Dhe në fund jam i shqetësuar me rritjen e borxhit publik në terma real jo si përqindje e bruto produktit vendor dhe ju mund të thoni se është në nivel ligjore që është 16%, por në qoftë se në terma real borxhi publik i Kosovës është 1.1 miliardë euro dhe nuk po arrijmë të krijojmë vende të punës, pra po humbim vende të punës, po besoj që jemi duke e shfrytëzuar një aset të rëndësishëm zhvillimor të Kosovës.

Tek pjesa financiare e buxhetit rritja e të hyrave mesatare prej 7% krahasuar nga vitit paraparak për tre vitit e ardhshme është në këtë proporcion, është gjithsesi më e ulët se sa rritja buxhetore e viteve të tjera që e ka pasur Kosova.

Më shqetësuesja është rritja e shpenzimeve për 12.5% përkundër rritjes së të hyrave për vetëm 7%, por në vazhdimësi po i rritim shpenzimet shumë më tepër se sa të hyrat. Në qoftë se të hyrat janë rritur për 132 milion euro për këtë vit, shpenzimet do të rriten për 260 milion.

Pjesa më e madhe e buxhetit është buxhet social. Kosova për herë të parë arrin pragun maksimal të kategorive sociale dhe skemave sociale, 60 milionë euro të këtij buxheti shkojnë në skema sociale, prej të cilave 100 milion euro shkojnë në skemën e listave të veteranëve të luftës dhe në diskutimin e tanishëm që e kemi me lista të fryra me procedura hetimore dhe fakti që Qeveria e Kosovës nuk bënë asgjë për t'i adresuar këto probleme dhe vazhdon më tutje të japin 100 milion euro në këtë skemë për mendimin tim është shqetësuese por është shumë shqetësuese që 54 % e buxhetit shkon në paga dhe në politikat sociale pra gjysma e këtij buxheti 2.4 miliardësh, 1.2 miliardë euro shkojnë në paga sociale. Pyetja ime për këtë çështje z. Ministër është a është i paraparë Ligji për paga në kategorinë e pagave? A mos duhet të jetë më e lartë kategoria e pagave dhe e dyta pyetje në këtë drejtim a është paraparë Ligji për mësimdhënësit e viteve të 90-ta në kategorinë e subvencioneve dhe çfarë obligime do të ketë?

A ka Qeveria qasje ndaj parandalimit të këtyre politikave sociale sepse në vend të mësuesit do të vijnë gjykatësit, mjekët dhe frika që po e shndërrojnë buxhetin investiv në buxhet të blerjes së paqes.

Unë i krahasova prioritetet e Qeverisë me shpenzimet buxhetore si vlerë reale, sepse si vlerë reale normalisht rritet çdo vit por si shpërndarje e buxhetit, pra sa përqind e buxhetit shkon në fusha të caktuara në sektorë të caktuar për shembull: në vitin e kaluar në buxhetin e juaj për çështje ekonomike, për infrastrukturë, inovacion, zhvillim ekonomik janë shpërndarë 20.6% buxhetit. Pra proporcionalisht buxheti ndahet më pak për çështje ekonomike se sa në vitin paraparak, por befasia më e madhe është që ndan edhe më pak në tri fushat tjera që për mendimin tim janë esenciale në rend dhe ligj pra si përqindje jo si vlera reale në arsim dhe në mbrojtje. Në vitin e kaluar kemi ndarë 9.24 %, ndërsa këtë vit vetëm 8.7 % e buxhetit shkon në rend dhe ligj, në arsim kemi ndarë 12.7% vitin e kaluar, ndërsa këtë vit do të ndajmë vetëm 12.4%, në mbrojtje kemi ndarë 6% ndërsa këtë vit do të ndajmë vetëm 2.4% dhe si është e mundur që në javët në vijim FSK-ja të bëhet ushtri, në anën tjetër pjesëmarrjen e buxhetin për ushtrinë e ardhshme të Kosovës e kemi në terma jashtëzakonisht të ulët vetëm 0.7% e bruto produktit vendor shkon në mbrojtje në këtë proporcion, Kosova është vendi me më së paku investime nga të gjitha vendet e rajonit. Vendet e rajonit e kanë 1.2%, vendet e NATO-së e kanë 2% e ne jemi në 0.7%.

Ndërkaq, ato prioritetet ku kanë rritje të buxhetit janë tri: Qeveria e përgjithshme që është një pjesë e tepruar e luksit qeveritar dhe rritet për 2%, në krahasim me vitin e kaluar në mbrojtje sociale, politika sociale dhe për vlerësim është shëndetësia. Por, nuk besoj që shëndetësia do të zgjidhet me shtimin e 5 milion euro për barna shtesë. Unë besoj që zgjidhja është tek sigurimi shëndetësor dhe tek sistemi i integruar brenda sistemit shëndetësor i cili nuk po na vjen edhe këtë vit. Edhe këtë vit po i lëmë kosovarët pa sigurime shëndetësor, kështu që barra i mbetet buxhetit. Unë kam vërejtje dhe kritika edhe për mënyrën se si shpërndahet buxheti, për prioritetet e Qeverisë brenda këtij buxheti, për faktin që buxheti nuk po realizon premtimet elektorale dhe për më tepër programi qeverisës që është diskutuar dhe votuar në parlament. Kam frikë që po e rrisim në terma real borxhin publik, po i shtjerrim mjetet e

privatizimit dhe në fund po japim rritje ekonomike prej 4% sepse nuk po adresojmë problemet kryesore që ka Kosova.

Blerim Kuçi: Ky projektligj është prej projektligjeve më të rëndësishme që kalojnë nëpër duart tona. Kryetari më shumë është bazuar në kornizën makroekonomike, mirëpo ajo që më habiti është se i nxori disa fakte në dëm të këtij buxheti. Për sa i përket punësimit, unë po i përmendi disa fakte të cilat janë në analizën makroekonomike të këtij projektligji. Ku thotë që papunësia ka rënë në shkallën 29.4%, kurse ka qenë në shkallën 30.6%. Ndërsa për elementet e tjera që janë treguesit më të mëdhenj për çështjen e punësimit është ATK dhe Trusti ku kemi fakte se sa të punësuar zyrtarisht janë. Ju folët me hulumtim të papërfunduar nga Enti i Statistikave, pra është një lloj hulumtimi jo i saktë. Kurse analizat makroekonomike në këtë projektligj thonë kështu, sipas të dhënave të Trustit Pensional që nuk ka argument më të fuqishëm kjo thotë që numri i llogarive aktive me fonde të qershorit të vitit 2018 është rritur për 2%.

Sipas të dhënave të ATK-së numri i të punësuarve është rritur për 18.700 vende të reja të punës këto janë fakte dhe ne duhet të themi edhe anët pozitive. Ky projektbuxhet është ana më pozitive që kemi dëgjuar kohëve të fundit. Po ashtu në krahasim me 2017 është rritur buxheti total 620 milion euro që bëjnë 36% krahasuar me vitin 2017 pra kjo Qeveri e ka rritur në total buxhetin për 36%. Pra janë këto disa fakte të cilat ju iu referuat në kornizën makroekonomike. Në formën specifike kishim pasur dëshirë të na tregoni cilat janë ato ndarjet buxhetore specifike që kanë të bëjnë me krijimin e vendeve të punës për të rinjtë? E kemi një kategori të mjekëve dhe punëtorëve shëndetësor që po ikin nga Kosova, çka kemi bërë për këtë kategori për të dhënë atyre shpresë për punësim?

Kryetari: Sipas ASK-së zotëri Kuçi ne faqen 6 thotë indikatorët e tregut të punës, sipas anketës 3 mujore të fuqisë punëtore janë të punësuar në Kosovë 341 mijë njerëz. Ndërsa ATK-ja thotë që janë 296 mijë njerëz, 60 mijë më pak, më tregoni a ti besojë ATK-së apo ASK-së? Mos e ngatëroni punësimin formal me punësimin joformal, ATK-ja e ka të regjistruar vetëm punësimin formal. Në Kosovë jo formaliteti i fuqisë punëtore është jashtëzakonisht i lartë, arrin deri në 30%.

Blerim Kuçi: Kjo ku referoheni ju është anketë. Në qoftë se ju i besoni më shumë anketës se Trustit dhe ATK-së atëherë diçka nuk është në rregull. Kemi të bëjmë me një anketë me një hulumtim. Unë si anëtar i Komisionit si deputetë jam i thirrur t'i besojë më shumë Trustit dhe ATK-së.

Kryetari: Zyra e Agjencisë të Statistikave është zyrë pranë Kryeministrit të Kosovës dhe kur fletë Qeveria për numrin e papunësisë nuk i referohet Trustit dhe ATK-së, por i referohet ASK-së.

Ali Lajçi: Do të orientohem tek politika makroekonomike dhe po të shikojmë kështu një trend të zhvillimeve për disa vite se nga është orientuar politika jonë ekonomike dhe cila është gjendja politike e menaxhimit ekonomike, ne e kemi një ekonomi tregtare në përgjithësi dhe nuk kemi një ekonomi prodhuese. Dhe që në fillim u konstatua që qeverisja e deritashme, jo për shkaqe politike sepse nuk do të duhej të ishte e drejtë që ne ta trajtojmë buxhetin në mënyrë direkte me motivet politike grupore e të tjera.

Orientimi i buxheteve në Kosovë bazohet në një ekonomi të menaxhimit të ndarjeve të tilla gati të njëtrajtshme, çështja e menaxhimit, metodologjia dhe pjesa ligjore e zbatueshmerisë e cila faktikisht tek ne është kaotike.

Në përgjithësi dominon kjo formë e buxheteve që shpenzohen në kuptim të pagave dhe mëditjeve dhe në shërbimeve dhe mallrave dhe kjo është si në nivelin qendrorë por edhe atë komunal.

Te kapitali unë nuk do të isha kundër ,sepse jam domosdo për të ofruar infrastrukturë të shërbimeve të përgjithshme dhe të investimeve të tjera, por ka shkuar në atë përmasë ku nuk është bërë një balancim si në zhvillimet tjera.

Në buxhetet komunale te hyrat vetanake janë shpërndarë ne shërbime dhe mallra, por tani është nevoja për zhvillime të reja dhe për kapitalin që ofron. E kemi një qasje tjetër te komunitetet në zonat ku nuk mundemi t'i administrojmë dhe mjetet buxhetore ngecin.

Ne kemi projektligje të cilat i aprovojmë por nuk i përcjellim në mënyre financiare e cila duhet të ishte për shembull kemi ligjet e FSK-së të cilat nuk janë përcjellur me kosto financiare e cila faktikisht do të duhet të ishte.

Madje çka mund të themi sistemin e drejtësisë, ku flasim për reforma dhe plotësim të standardeve evropiane, por kjo nuk përcillet me buxhet. Rritja e buxhetit për Kryeministrin dhe Presidentin është qind për qind. Sa i përket buxhetit për komunat, kur bëhen krahasimet në komunat tjera që kanë numër më të madh të banorëve edhe pse nuk jemi kundër asnjë komune, por del një disproporcion. Është me rëndësi të përmendet se nuk kemi një menaxhim të mirë buxhetore që kërkohet nga qytetarët që menaxhimet buxhetore, shpërndarjet dhe shpërfillja e burimeve, mospërfillja e institucioneve ligjore dhe madje edhe buxhetet pastaj shkojnë në këso forma kaotike.

Arbërie Nagavci: Unë ndoshta po e thëmë pak si konstatim por pak edhe si pyetje duke thënë se buxheti nuk është as transparent e as i konsoliduar, prandaj pyetja e parë është se: A është buxheti i konsoliduar sepse kemi parasysh se të gjitha të hyrat e Republikës së Kosovës edhe pse në nenin 11 përmendet se të gjitha të dhënat janë të paraqitura në mënyrë specifike duke u përfshirë edhe në tabelat financiare gjë që nuk ndodhë në dhënat në raport përmenden por nuk janë të përfshira në tabelat buxhetore pra nuk përmendet saktë se sa janë të hyrat nga fondi i veriut, a është rritur ky fond e tjera si këto në mënyre specifike në tabelat financiare? Sa i përket asaj se nuk është transparent, në nenin 16 është e paraparë që ministri nëse i ofrohen arsytetime të vlefshme të ndryshojë vlerën deri ne 15% nga vlera totale e kategorisë të shpenzimeve kapitale që janë paraparë, pra të ridestinojë mjetet për një projekt dhe me lejen e Qeverisë deri ne 25%, pra kjo mundëson që projektet të cilat janë të planifikuara a mund të ndryshohen me vendimin e Ministrisë apo Qeverisë që lejon që buxheti të përdoret për qëllime ndoshta klienteliste apo konkretisht partiake.

U përmend edhe nga kryetari edhe nga z.Lajçi po e parashtraj si pyetje pse nuk janë përfshirë projektligjet e administratës publike? Po ashtu pakoja e ligjeve nga sistemi i drejtësisë nuk janë paraparë dhe po ashtu nuk janë paraparë edhe të hollat për shtesat e fëmijëve për të cilat është miratuar rezoluta në Kuvend. Pyetja ime është se a do të realizohen apo jo sepse nuk janë të parapara këtu sikur se as ligji i lehonisë nuk është buxhetuar? Vlen të përmendet se në zyrën e kryeministrit janë shumëfishuar shpenzimet, gjegjësisht janë rritur nga 1 milionë në 10 milionë. Pse është destinuar kjo shumë kaq e madhe e shpenzimeve pa e përmendur edhe rritjen tek Zyra e Presidentit. Pjesa më e madhe e shpenzimeve i takon Ministrisë së Infrastrukturës, ndërkohë që vetëm tek ndërtimi i autostradave shihet se janë planifikuar 78 milionë e 500 mijë euro. Në arsimin para universitar janë paraparë 10 milionë e prej tyre vetëm 250 mijë janë projekte të reja dhe pyetja ime është se sa shkolla të reja dhe çerdhe do të ndërtohen? Me sa unë e pashë janë kryesisht projekte ekzistuese të filluara më herët. Tek Ministria e punës e konsideroj të rëndësishme ta përmendi se më shumë mjete shpenzon në renovimin dhe blerjen e veturave dhe shohim se është planifikuar të ndërtohet vetëm një qendër për banim social që është planifikuar të jetë në Malishevë.

Safete Hadergjonaj: Dua ta përgëzoj ministrin dhe stafin e tij për një përgatitje kaq të mirë të buxhetit ku janë të dhënat, të gjitha shifrat të cilat janë të paraqitura në buxhet. Ajo që duhet të vlerësohet është që në këtë buxhet janë ruajtur të gjitha kategoritë të cilat janë paraparë me ligj që duhet gjithsesi të respektohen. Unë dua ta vlerësoj ruajtjen e rregullës fiskale prej 2% e cila edhe përkundër kërkesave të shumta ministria ka arritur të bëjë një planifikim të buxhetit dhe duke e ruajtur këtë rregull. Borxhi publik ka pasur tendencë të rritur që në mandatin e kaluar, por po e shohim që nuk ka shkuar me rritjen enorme sikur se ka filluar, e arsyetoj edhe një borxh të tillë publik nga se po shohë se nga planifikimi që ministria ka bërë ka qenë shumë i kujdesshëm. Ajo çka mua më shqetëson më shumë është që ka shumë projekte për të cilat ne kemi hyrë në borxh, por faktikisht nuk po i shohim të realizuara. Unë edhe vitin e

kaluar e kam pasur këtë shqetësimin e mos shpenzimit të kësaj kategorie të mjeteve, e kemi pasur mbi 100 milionë të planifikuara ,për shembull në vitin 2016 kemi realizuar diku 45 milionë dhe ka pasur pagesa 7-8 milionë pagesa që janë bërë për këto projekte, ku ne faktikisht kemi hyrë në borxh.

Gëzohem që planifikimi buxhetor është bërë në shifra konkrete por reflekton një rritje prej 4.5%. Është shumë e rëndësishme që burimet e kufizuara të të ardhurave të cilat faktikisht ne i kemi këtu, duhet shpërndarë në mënyrë të kujdesshme duke i adresuar çështjet të cilat janë si prioritetet i Qeverisë dhe të cilat reflektojnë edhe në zhvillimin ekonomik edhe në arsim edhe në shëndetësi por njëkohësisht reflektojnë edhe në mirëqenien e qytetarëve. Kjo çështje në buxhet është adresuar në mënyrën më të mirë dhe ky planifikim ka një performancë të mirë të të hyrave buxhetore çka do të thotë që vjen duke u rritur gradualisht rritja e të hyrave dhe nuk ka reflektuar marrëveshja për stabilizim asociativ në rënien e të hyrave të cilat kanë mundur të reflektojnë edhe në buxhet.

E shohë që ka një rritje edhe të të hyrave buxhetore por më gëzon fakti që disa ndryshime të cilat janë bërë në legjislacionin e të hyrave jam e bindur që do të jetë një projekt i realizueshëm për vitin e ardhshëm dhe të shkojë trendi i rritjes në këtë që është planifikuar dhe të realizohen të hyrat të krijuhen mundësi për kryerjen e të gjitha shpenzimeve të cilat janë paraparë. Po ashtu kam vërejtur që të gjitha organizatat buxhetore kanë rritje dhe orientimi i buxhetit kryesisht është bërë në prioritetet të cilat i ka vënë Qeveria para vetes. Nëse ne e shohim me kujdes buxhetin e shohim se 66% të shpenzimeve rrjedhëse shkojnë në shifrën e përgjithshme të shpenzimeve, mirëpo ministri e sqaroi se ka një lëvizje të madhe pikërisht të mallrave dhe shërbimeve duke i adresuar disa çështje që kanë pasur të bëjnë me të drejtën e autorit. Ajo çka është për të vlerësuar është se është ruajtur trendi i shpenzimeve kapitale ku përfitojnë qytetarët. Buxheti për vitin 2017 ka ardhur pa treguesit makroekonomik do të thotë se ne nuk kemi pasur mundësi të shohim trendin apo analizën e treguesve fiskal. Buxheti i vitit 2017 ishte në kontradiktë të madhe me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve dhe nuk i ka adresuar prioritetet e Qeverisë. Dua ta kujtoj që kanë qenë 13 organizata buxhetore të cilat e kanë pasur buxhetin copy paste do të thotë vetëm e kanë kopjuar buxhetin e viti 2016. I kemi pasur 90 projekte 60 prej tyre kanë qenë të planifikuara vetëm me 50 mijë euro kurse 26 projekte tjera kanë qenë të planifikuara me 100 mijë euro që ka bërë që këto projekte të mos realizohen.

Naser Osmani: Duhet pasur parasysh se buxheti në Kosovë ka gjithmonë një kontinuitet dhe nuk ka asnjëherë një ndryshim radikal. Unë kisha dashur të kërkojë më tepër disa sqarime prej ministrit lidhur me këtë dokument që është jashtëzakonisht i rëndësishëm dhe ka të bëjë me të hyrat dhe të dalurat buxhetore. Tek të hyrat buxhetore është paraparë një rritje prej 132 milionë euro por kur kihet parasysh që trendi i 9 mujorit ka një rritje vetëm 6% dhe kur kihet parasysh që ka një rritje të buxhetit kaq e cila krijon një mundësi për tu vjelur kjo e hyrë. Po shohë që e kemi paraparë të hyra prej TVSH-së,tani e kemi në procedurë edhe Projektligjit i TVSH-së mirëpo kur të kihet parasysh fakti se me këtë projektligj parashihen disa beneficione apo disa lehtësira në këto politika fiskale, sidomos te prodhuesit vendor që i kemi liruar me ndihmën e Qeverisë importet e IT-së dhe kjo do të ketë impaktë në të hyrat buxhetore. Ajo që për mua është brengosja më e madhe e këtij shteti janë kategoritë e subvencioneve dhe transferove dhe kemi ardhur në një situatë ku transferet dhe subvencionet janë barazuar me pagat dhe mëditjet. Tani me veteranët e luftës kam një mendim që veteranët duhet ti largojmë prej ligjit, këta duhet të krijojnë një fond të cilin ata kanë për ta menaxhuar që të mos jenë më pjesë e ligjit. Tani çështja e shtesave të fëmijëve ku me sa di unë ka pasur një implikim prej 60-70 milionë që shtrohet pyetja ku do të marrim ato para dhe që është një gjë të cilën është vështirë të mos e përkrahim. Pastaj ligji për paga konsistoi që është dashur të insistohet në Qeveri që ai ligj të vijë përmes Ministrisë së Financave e jo nëpërmjet Ministrisë së Shërbimeve Publike. Tek investimet kapitale janë disa projekte që me të vërtet nuk kanë kuptim. Normalisht, ne e kemi thënë gjithmonë që do të ishte mirë të jetë një buxhet i cili në projeksionet e veta kapitale do të ketë një prioritet që të përfundojnë projektet e filluara, do të thotë të përfundojnë ato projekte që po zgjasin me vite. Por kjo gjë as nuk po mundet të ndodhë as nuk do të ndodhë ndonjëherë. Kam edhe një pyetje: Kontigjenca në Ministrinë e Financave është më e madha, pse është bërë një gjë e tillë?

Enver Hoti: Shihet edhe nga ajo që e deklaroi ministri edhe nga ajo që e kemi në dokument se buxheti i vitit 2019 është i realizueshëm, i qëndrueshëm dhe çfarë është më e rëndësishmja është se e ruan stabilitetin. Po ashtu, prioritetet të cilat i ka adresuar për vitin 2019 siç është drejtësia, arsimi dhe shëndetësia unë mendoj që duhet të merren parasysh edhe ato fusha të cilat për herë të parë ndoshta kanë një qasje, si trajtimi i ujërave të zeza, mbeturinat, që ndikon pozitivisht në zhvillimin e vendit sepse është diçka e domosdoshme për tu bërë. Për tu trajtuar pozitivisht është zvogëlimi i formalitetit, pra masat të cilat janë marrë nga Qeveria qoftë nga ju si ministri dhe në sistemin e drejtësisë po fillojnë të japin rezultatet e veta në rritjen e të hyrave duke e zvogëluar formalitetin. Ajo që bie në sy është edhe ndarja e balancuar dhe e përpunuar pa implikime të theksuara dhe të vazhduara siç kanë qenë deri më tani politike, por janë disa të ndara të cilat janë të balancuara dhe mendoj që duhet vlerësuar. Më shqetësojnë të hyrat vetanake të komunave, nuk e di se si duhet të shtohet një aktivitet shtesë që të realizohet sepse mund të ketë shtesa në këtë pjesë. Në skemat sociale kemi parë se ka përfitues të dyfishtë të skemave sociale, përfitues të cilët nuk e meritojnë, nuk i plotësojnë kriteret dhe këtu mendoj se Qeveria mund të jetë më aktive. Ministër kishim dashur që në sektorin e bujqësisë të shohim një mbështetje më të madhe që do të jepte mundësi për zhvillimin e bujqësisë dhe ndryshimin e parametrave të importit dhe eksportit dhe të hapte vende të punës dhe ne kemi nevojë që të shtojmë më tepër aktivitetin dhe mbështetjen në bujqësi dhe në hartimin e politikave të qëndrueshme.

Fikrim Damka: Do të fokusohem në buxhetin të cilin e kanë ndarë për komunitetet. Siç e dijmë, komunitetet tjera nuk kanë pasur mundësi për të ndërhyre në buxhetin e Ministrisë së Komuniteteve, dhe me Ministrinë e Financave në buxhetin e vitit 2018 e kemi gjetur një kompromis se buxheti për komunitete të përfshihet në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, por kemi pasur një neglizhencë nga kjo Ministri me realizimin e disa projekteve nga ky komunitet dhe para dy ditëve kemi ndikuar tek Ministria që të hapet tenderi dhe shpresoj të mos dështojë. Edhe pse u tha se ky buxhet ka rritje në kodin e projekteve të komuniteteve në Ministrinë e Punës ka një zvogëlim dhe shpresoj që gjatë leximit të dytë do ta korrigjojme këtë çështje. Po ashtu në Zyrën e Kryeministrit në buxhet për komunitete në minimum janë të mbështetura komunitetet tjera dhe këto komunitete kanë qasje të vogël në këto fonde. Po ashtu, do të kërkoj korrigjime edhe në komunën e Mamushës ku për disa vite kryetari i Mamushës ka lënë anash prioritetet e kësaj komune sidomos në shëndetësi dhe arsim dhe kjo komunë nuk e ka QKMF-në dhe besoj që këtë vit do të kërkoj mbështetje që të ndërtohet kjo qendër dhe do të përmirësohet gjendja në shëndetësi dhe nga kjo komunë marrin shërbime edhe qytetarët e fshatrave të tjera.

Mërgim Lushtaku: Sigurisht që na gëzon fakti që do të ketë rritje të të hyrave të buxhetit të Kosovës. Në përgjithësi kemi parë që është shtjelluar mjaft mirë projektbuxheti për vitin 2019, sigurisht që edhe në pajtohemi me disa çështje që i kanë ngritur edhe kolegët, ne jemi në pjesën legjislative dhe pjesë e jona është edhe mbikëqyrja dhe vendimmarrja në fund se a do të jetë ky si projektligj. Pjesa ku unë mendoj se duhet të ngritemi në vazhdimësi është edhe pjesa e rinisë dhe papunësisë pasi që jam edhe anëtar jo formal i grupit të të rinjve dhe kam parë që duhet të ketë politika më të theksuara këtë vit dhe kam parë se mungon një lloj diagrami për ndarjen e buxhetit për politikën e ndryshme në këtë drejtim është edhe ndarja në bazë të gjeneratave të ndryshme, se çfarë politike bëjnë për moshat e reja, moshat e vjetra por edhe për politikën e ndryshme. Në këtë aspekt çështja e punësimit ose e papunësisë edhe pse kemi parë nga statistikat e ndryshme qofshin ato të entit të statistikave edhe pse janë në kundërshtim ato të administratës tatimore dhe trustit po gjithsesi e kemi një lloj bilanci që duhet të marrin në si deputet modulën mesatar se cila është e realitetit pasi që e dimë se kemi një lloj informaliteti të madh dhe këto besoj që kemi nevojë edhe ju si Qeveri por edhe ne si deputet e ngrisim zërin që të luftohet informaliteti edhe më shumë që të kemi një rritje të buxhetit njëkohësisht por edhe zvogëlimin e papunësisë.

Në këtë aspekt duke ndërlidhur me çështjen e punësimit sigurisht që e kemi parë që kemi praktikues të veçantë të mbështetjes buxhetore në ministri të caktuara që lidhen kryesisht me çështjen e punësimit, siç është Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Kulturës që ka të bëjë me rininë dhe sportin

por besoj që nuk është e mjaftueshme që në këtë drejtim duhet të shqyrtohen se cilat janë projektet të cilat e rivitalizojnë çështjen e punësimit të të rinjve. Në këtë aspekt besoj që ndërlihet pjesa e zhvillimit ekonomik, krijimi i infrastrukturës dhe ambientit më të mirë për investime të huaja dhe besoj që duhet të bëhet më shumë në këtë drejtim.

Trendi në mes importit dhe eksportit besoj që në këtë drejtim do të mundohet me subvencionimin me eksportuesit e jashtëm kemi shembuj të ndryshëm perëndimorë dhe botëror që eksportuesit i subvencionojnë në mënyrë që të jenë konkurrentë me ata ndërkombëtar dhe sigurisht që kjo do të rriste edhe çështjen e zhvillimit ekonomik të punësimit dhe sigurisht edhe të hyrave të Kosovës. Te pjesa e luftës së informalitetit unë kam një pyetje për ministrin në këtë drejtim: Cilat janë hapat e juaj për luftimin informalitetit dhe që të zvogëlohet një në farë mase kjo dukuri?

Albulena Haxhiu: Tash se fundmi siç jemi në dijeni, komisioni për legjislacion ka pasur për trajtim diku 18 projektligje që lidhen me sistemin e drejtësisë dhe të gjitha prej këtyre i kemi shqyrtuar dhe kemi bërë amendamente. Shumë prej tyre ndoshta 11 janë në seancën e së premtes dhe nëse e shohim buxhetin për vitin 2019 vërejmë që të paktën bindja ime është që nuk ka një komunikim të ministrive, nuk po flas këtu për organizatat buxhetore të tjera por të ministrive përkatëse, në këtë rast Ministrisë të Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave.

Pastaj, çështja e lehonave ku sipas ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale z.Reçica kjo është për t'u vlerësuar, mirëpo kjo nuk është adresuar në buxhet. Pastaj, kemi PL për punëtorët e arsimit shqip, kjo nuk është adresuar në buxhet. Ne sistemin e drejtësisë nëse e krahasojmë buxhetin Zyra e Kryeministrit i ka 18 milion buxhet, ndërsa KPK-ja ka 42 milion buxhet më shumë se vitin e kaluar po të gjitha shkojnë në paga dhe mëditje për shkak të vendimit të pa ligjshëm për rritjen e pagave. Edhe në shtet ju kemi dëgjuar shpesh të flisni për forcimin e sistemit të drejtësisë por nëse një qeveri është interesuar që të ngrit sistemin e drejtësisë atëherë kjo duhet të reflektojë në buxhet, 1.8% e totalit ndahet për sistemin e drejtësisë.

Ju thatë që keni pasur kontakte me të gjitha organizatat buxhetore dhe ky projektbuxhet është si rezultat i diskutimeve me to, por që në anën tjetër ende pa kaluar në parim neve në komision na kanë ardhur shumë organizata buxhetore për të kërkuar dhe për të na thënë që nuk i kemi përkrahur kërkesat buxhetore. Agjencia Kundër Korrupsionit vetëm 4 mijë euro ka rritje të buxhetit, nuk keni ndarë buxhet të veçantë për Sinjalizuesit. Agjensioni kundër korrupsionit do të ketë kompetencë të re që çfarëdo projektligji që vjen në Kuvend të vlerësohet në aspektin e korrupsionit. Në qoftë se neve na kanë ardhur në komision: Ambasada Amerikane, Zyra e BE-së, Qeveria të na thonë që të votojmë sa më shpejtë 18 projektligjet sepse nuk do të kemi liberalizimin e vizave atëherë në qoftë se këto ligje miratohen në Kuvend, por nuk ka ndarje buxhetore për këto, çfarë kuptimi ka që ti votojmë. Ju kisha lutur që të na jepni informacione edhe për Ligjin e Gjykatave, ne kemi konsideruar që duhet dhe e kemi adresuar në departament special paralel me prokurorin special në kuadër të Gjykatës Themelore, kjo ka implikime buxhetore, Komisioni për buxhet ka thënë 3 milionë euro. Sipas legjislacionit që e kemi votuar, secili prokuror dhe gjyqtar do ta ketë nga një bashkëpunëtor profesional, as kjo nuk është paraparë në buxhet, po ashtu dega e Gjykatës Themelore në Han të Elezit, as kjo nuk është paraparë në buxhet. Ku do ti merrni këto para dhe a e keni ndërmend që në shqyrtim të dytë ti adresoni këto çështje?

Shemsi Sylja: Unë nuk jam i profesionalizuar në këtë fushë, megjithatë meqë është e cekur FSK-ja dhe vij nga ajo sferë ndihem i shqetësuar dhe njëkohësisht kam dashur të vij që të parashtoj disa pyetje dhe të shikojmë se çfarë është për dhe çka është në plan të bëhet. Është një fakt që në kornizën tre vjeçare nuk ka ndikim të shtimit, nuk kemi argumente që na vërtetojnë që është bërë de facto një investim i cili prioritet ka krijimin e ushtrisë dhe forcimin e strukturave dhe kapaciteteve të saj. Rrjedhimisht nga ky shqetësim ku shtetet tjera kanë bërë një rritje të buxhetit në aspektin e forcimit të ushtrisë atëherë është një brengë për ne për këtë do të shtroj disa pyetje: Ku i keni burimet dhe si e keni idenë që nesër të plotësohen normat e buxhetit për të krijuar ushtrinë apo për ta transformuar dhe a ka mundësi që të dimë burimet prej nga dhe ku do të merren? Si e keni paraparë ju? Nga i siguroni ato mjete?

Bedri Hamza: Unë edhe në paraqitjen time të parë e thash që kishim dashur të kishim më shumë por këto janë mundësit reale të Kosovës për financimin e nevojave. Nuk është buxhet që i reflekton nevojat e Kosovës por është buxhet i draftuar dhe i punuar në përputhje me mundësit reale për financim.

Çka është me rëndësi, është e pamohueshme ka rritje 12.5% në krahasim me vitin aktual që shprehur me miliona është 261 milionë më tepër. Rritja e ekonomike- derisa Qeveria e kaluar e ka konsideruar si arritje më të madhe rritjen ekonomike prej 4.1%, unë po them që për vitin 2017 dhe e dhënë zyrtare rritja ekonomike është 4.23% do të thotë, ja ka kaluar asaj Qeverie. Por, pavarësisht që Kosova ka pasur në 10 vjeçarin e fundit rritjen ekonomike më të madhe në regjion nuk është e mjaftueshme për ti adresuar sfidat kryesore të ekonomisë sonë dhe ne kemi nevojë për një rritje ekonomike të nivelit tjetër, Mirëpo nëse fillojnë projektet siç është Kosova e Re që është një projekt duke u zhvilluar atëherë rritja ekonomike do të kalojë në një nivel tjetër.

Sa i përket numrit të vendeve të punës është me rëndësi që për herë të parë një diçka e tillë i bashkëngjitet buxhetit. A është më i saktë Trusti apo ATK-ja, megjithatë ne mund të themi që norma e papunësisë në Kosovë vazhdon të jetë e lartë fatkeqësisht, posaçërisht tek të rinjtë.

Sa i përket deficitit tregtar ne kemi nevojë për reforma strukturore dhe sa më shpejtë ti bëjmë këto reforma strukturore është më mirë për vendin. Kemi nevojë të përkrahim sektorin punues, sektorin e shërbimeve me qëllim të eksportit ne kemi deficit tregtar në tregti me mallra por kemi suficit në tregtinë me shërbime. Tek borxhi publik trendi i borxhit publik është stabilizuar nëse i referohemi trendit se sa është rritur në të kaluarën vit në vit, tash trendi nuk është rritur por është stabilizuar dhe Kosova vazhdon të ketë pozitë të qëndrueshme për sa i përket borxhit publik, mirëpo në asnjë moment nuk guxon neve të na vendosë në pozita komode. Qeveria dhe institucionet e Kosovës duhet të huazojnë për projektet që kanë kthim. Kosova e ka procedurën më të komplikuar sa i përket aprovimit të borxhit publik.

Tek pjesa e rritjes së tatimeve, tatimet po rriten por ka një dallim me situatën paraprake. A po rriten si rezultat i rritjes ekonomike dhe si rezultat i zvogëlimit të informalitetit apo rriten si rezultat i rritjes së normave prej 16-18%. Te rritja e shpenzimeve, është rritur buxheti tek pjesa e të dalurave 12.5% , janë rritur të gjitha kategoritë e shpenzimeve edhe pagat, mallrat e shërbimeve, subvencionet dhe transferet edhe kapitalet.

Është jashtëzakonisht pozitive që është ruajtur struktura e buxhetit nuk ka dallim të madh përqindja e pjesëmarrjes të investimeve kapitale e buxhetit, nuk ka dallim të madh në faturën e pagave dhe tek tjera struktura dhe unë uroj që edhe në vitet e ardhshme Kosova të ketë kujdes tek struktura e buxhetit derisa tek vendet e tjera te regjionit kur i bëjmë krahasimet ka vende që nuk kanë dhe nuk e di pse zhvillojnë procedurën buxhetore sepse komplet buxheti i tyre shkon në obligime ligjore dhe në pagesën e pagave, mëditjeve, transferove, ndërsa pjesëmarrja në investimet kapitale shkon prej 4% deri në 15% më së shumti.

Kosova këtë vit i ka të planifikuara 33%, unë uroj që organizatat tona buxhetore kur po vijnë në ekzekutim shohim që në kapitale mbesin prandaj duhet gjetur një farë ekuilibri në mes të kërkesave dhe mundësive për financim. Tek skemat sociale unë si ministër i financave besoj që prej parimeve popullore dhe rritjes së faturës së transfereve sociale. Është duke u diskutuar reforma e administratës publike, që disa herë është duke ardhur në Kuvend dhe është duke u kthyer, është në ministrinë e administratës publike, është në një mënyrë edhe pjesë e raporteve kontraktuale me BE-në, lidhen edhe fonde të caktuara me zhvillimin e reformës.

Tek Ministria e Financave e kemi një kontingjent që është diku rreth 10 milion, ky kontingjent është i dedikuar për mbulimin e koston e iniciativave të reja që janë në Kuvend ne nuk mundemi me paragjyku koston ekzakte të ligjit për paga, mundet të pësoj ndryshime gjatë trajtimit në Kuvend, mundet me qenë më e vogël ose më e madhe.

Ligji për mësimdhënës e kemi paraqitur tek Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, i sponsorizuar nga Ministria e Arsimit i paguar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, është reflektuar kostoja e ligjit por ende nuk e di se cila do të jetë kostoja e kësaj. Transformimi i FSK-së në Forca të

Armatosura, e vetmja organizatë buxhetore pra që unë nuk kam negociuar, kemi thënë po Ministria e Financave e përkrahë kërkesën e ministrisë të FSK-së sepse është prioritet dhe e kemi reflektuar në draftin aktual që është në buxhet 100%. Sigurimet shëndetësore, 3.5% i paguan punëtori, 3.5% punëdhënësi dhe çeku i pagave mujore është 50 milionë afërsisht do të thotë del që për tre mujorin e fundit është 40 milionë e gjysmë për shpenzime shëndetësore. Znj.Nagavci po buxheti është transparent dhe i konsoliduar nuk ka më transparent se deri në detajin e fundit për secilin projekt e ka kodin.

.Z.Osmani tha me të drejtë e kemi ligjin bazik për ne për përgatitjen e buxhetit që është Ligji për Financat Publike he Përgjegjësitë që rregullon qështjen e ridestinimit të projekteve kapitale, përqindjet dhe institucionet që e bëjnë atë.

Tek sektori i drejtësisë ti marrim rrogat dhe ti krahasojmë me regjionet këtu prokurorët tanë i kanë rrogat më të mëdha dhe ka ende pozita të paplotësuara. Po në anën tjetër duhet të bëjmë edhe pyetjen sa është duke u zvogëluar numri i lëndëve në gjykata? Sa është duke u rritur efikasiteti ?

Rritja e investimeve në Kryeministri dhe Presidencë, tek Kryeministria është Agjencia e Veterinës, Agjencioni i Statistikave është Zyra për Komunitete dhe nëse rritet buxheti në këto agjencione mund të themi se është rritur buxheti në kryeministri. Tek çështja e deficitit që z.Osmani e ngriti me të drejtë, deficitin është kështu dhe me rregulla të cilat janë vendosur bashke me FMN-në dhe janë rregulla për deficitin primar dhe janë tri rregulla dhe janë respektuar.

Është mirë që këto mjete nuk kanë të drejtë që të përdoren për financimin e shpenzimeve rrjedhëse duhet lidhur me financimin e investimeve kapitale.

Mbështetja për bujqësinë përveç fondit të tregut ata kanë financim edhe përmes kredive të bankës botërore edhe unë besoj që duhet me pa strukturat e subvencioneve. Buxheti për komunitete, kemi biseduar për ato projekte, unë jam i gatshëm që këtë çështje me trajtuar në Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe brenda mundësive reale fondi i cili është propozuar aktualisht të rritet në nivel tjetër i cili i mundëson realizimin e projekteve për të cilat ka qenë i ndarë.

Znj.Haxhiu, 18 projektligje që përmendet, secili ligj që del mbi koston të cilën e ka marrë dhe është aprovuar kjo qeveri duhet të ketë kujdes. Ministria e Financave e ka dhënë deklaratën sqarimin e nevojshëm që kjo kosto është e paraparë dhe nuk besoj se këto ligje janë ligje të cilat e rrezikojnë qëndrueshmërinë e stabilitetin makro fiskal të vendit. Unë të siguroj që shteti çdo herë ka mundësi me modelu zgjidhje të pranueshme, nuk është problem nëse Agjencioni Anti Korrupsion i kërkon edhe 50 mijë, 100 mijë edhe 200 mijë euro shtesë nuk është aspak problem sigurohen, Ministria e Financave ka problem me siguru fondet prej 20, 30,50 dhe 100 milionë. Ata kryesisht kanë paga, mëditje, mallra, shërbime ndonjë punësim të ri por nuk kanë projekte kapitale.

Kryetari: dua të them që komentet e bëra në komisionin tonë janë më tepër ndaj Qeverisë së Kosovës e jo vetëm ndaj Ministrisë së Financave është Buxheti i Republikës së Kosovës dhe rrjedhimisht kur vjen një kërkesë prej z.Hoti për shembull që duhet paga shtesë për mësuesit, por është projekt i Qeverisë dhe kur Qeveria s'kërkon fonde shtesë për Ministrinë e Mbrojtjes. Sepse ka kërkesa të shtuara në komision për paga e kërkesa të tilla, por aftësia jonë për t'i parandaluar ato është që nuk ka vullnet brenda Qeverisë.

Pas përfundimit të diskutimeve kryetari konstatoi se janë 10 deputet pjesëmarrës në votim dhe me 6 vota për, 4 vota kundër dhe asnjë abstenim, nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë në parim Projektligjin nr.06/L-133 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe i amendamenteve të Komisionit funksional për Punët të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së

Kryetari: Theksoi se projektligji përmban kosto, por qe është e përballueshme, ndërsa amendamentet nuk përmbajnë kosto shtesë buxhetore.

Pas sqarimeve, kryetari konstatoi se Komisioni unanimisht nxori

Rekomandim

Projektligjit nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, përmban kosto te përballueshme për Buxhetin e Republikës se Kosovës. Ndërsa ,amendamentet e komisionit funksional për Punët të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së nuk përmbajnë kosto shtese buxhetore.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-115 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2003/24, Ligji i Sportit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin 04/L-075 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2003/24 për Sport dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi

Kryetari: Theksoi se projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë kosto shtesë buxhetore.

Pas sqarimeve, kryetari konstatoi se Komisioni unanimisht nxori

Rekomandim

Projektligjit nr. 06/L-115 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2003/24, Ligji i Sportit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin 04/L-075 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2003/24 për Sport dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi, nuk përmbajnë kosto shtesë buxhetore.

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.05/L-090 për sponsorizime në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi;

Kryetari: Theksoi se projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë kosto shtesë buxhetore.

Pas sqarimeve, kryetari konstatoi se Komisioni unanimisht nxori

Rekomandim

Projektligjit nr.06/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.05/L-090 për sponsorizime në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi nuk përmbajnë kosto shtesë buxhetore.

7. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.05/L-075 për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive, dhe

amendamenteve të Komisionit funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi;

Kryetari: Theksoi se projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë kosto shtesë buxhetore.

Pas sqarimeve, kryetari konstatoi se Komisioni unanimitisht nxori

Rekomandim

Projektligjit nr.06/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.05/L-075 për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive, dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi nuk përmbajnë kosto shtesë buxhetore.

8. Të ndryshme

8.1. Naser Osmani: Njoftoi se grupi punues për shqyrtimin e Projektligjit për tatimin në të ardhurat personale dhe Projektligji për tatimin në të ardhurat e korporatave ka përfunduar punën për shqyrtimin e tyre dhe ka mbajtur një punëtori jashtë Kuvendit, ku janë bërë disa shpenzime, për çka kërkoi nga Komisioni që të mbuloje shpenzimet me Buxhetin e Komisionit.

Komisioni unanimitisht nxori këtë vendim:

1. Mbulohen shpenzimet e krijuara në Punëtorinë e Grupit Punues të Komisionit për shqyrtimin e Projektligjit për tatimin në të ardhurat personale dhe Projektligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave, të mbajtur në Prevallë me datë: 19 Nëntor 2018;
2. Ngarkohet Drejtoria për Buxhet dhe Pagesa e Kuvendit, që ta zbatojë pikën 1 të këtij vendimi, nga buxheti i Komisionit.

8.2. Naser Osmani: Propozoi që të formohet grupi punues për Projektligjin për Tatimin mbi Vlerën e shtuar dhe të jetë i njëjti grup si ai për dy projektligjet tatimore paraprake.

Komisioni caktoi grupin punues për Projektligjin për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, me këtë përbërje:

Naser Osmani - kryesues
Safete Hadergjonaj - anëtare
Blerim Kuçi - anëtar
Ali Lajqi - anëtar
Jelena Bontic - anëtare

Mbledhja përfundoi në orën 12:05.

Përgatitur nga njësia mbështetëse e komisionit

Kryetari komisionit,

Lumir Abdixhiku